



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. 856 Regj.Them
Date 15.05.2017

VENDIM

“ NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTAR; ARBEN KOSTANDINI

asistuar nga sekretare Merita Lila, sot ne **dt.31.05.2017** mori ne shqyrtim kerkesen penale qe I perket:

KERKUES **L. B..i biri Xh. dhe F. dtl. 07.07.19.. banues ne Rr.’’...’’ Bathore**
Tirane mbrojtur Sadri Ahmeti me nr.licence 1607

ME PJESMARJEN : Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane Perf nga Prokurori
Alketa Zifla.

OBJEKTI: ; Heqjen e sekuestros dhe ktjimin e mjetit tip autoveture BMW X-5 me
targa
AA 5.. ABne pronesi te L. B..

BAZA LIGJORE ; Neni 301 K.Pr.Penale

Kerkuesi dhe Av. I tij kerkuan pranimin e kerkeses sipas objektit , Prokurori e la ne cmim te gjykates

V Ë R E N :

Prokuroria e rrethit gjyqësor Tirane,ne daten 11.04.2017, mbi bazen e materialit referues te Komisarariatit te Policise Nr.5 Tirane, ka regjistruar procedimin penal per vepren penale te 'Perndjekje 'dhe 'Mardhenie seksuale me dhune me te ritura' parashikuar nga Neni 121/a/2 dhe 102/1 te KP te personit nen hetim L. B..

Rezultoni se, gjate veprimeve ne hetimet paraprake, organi i akuzes, bazuar ne aktet e ndodhura ne fashikullin gjyqesor Nr.772 Vendimi, date 13.04.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, si dhe ne aktet e fashikullit te procedimit penal te vitit 2017 rezulton se me Proces Verbalin e dates 04.04.2017 eshte bere sekuestrimi I makines tip BMW X-5 me targa AA 5.. AB me ngjyre te zeze ne pronesi te shtetasit L. B..nga Oficeri I Policis Gjyqesore . Mjeti I mesiperm I sekuestruar me cilesine e proves material eshte lene ne ruajtje prane Pikes se Bllokimit te Mjeteve Motorike ne Lunder Tirane .

Ne lidhje me kete sende, te siper cituar, te sekuestruar, per llogari te ketij procedimi penal, me gjithë kerkesen e kerkuesit per kthimin e tij ,nuk eshte kerkuar nga prokurori, por as nuk rezulton te jete marre nje vendim per ecurine dhe fatin kesaj makine.

Gjate ketij hetimi gjyqesor ka rezultuar se te gjitha aktet per te cilat pala kerkuese ka ngritur pretendimin dhe kerkon kthimin e sendeve-provave te sekuestruara, rezultojne te jene te sekuestruara dhe te administruara ne kete fashikull te atij procedimi penal.

Nuk rezulton se mjeti te kete lidhje me veprat pelale per te cilat dyshohet kerkuesi.

Provohet sipas Vertetimit te Drejtoris Pergjitheshme te Transportit Rrugor Drejtoria Rajonale Tirane me Nr ... prot date 31.05.2017 se mjeti I sekuestruar me siper eshte prone e kerkuesit L. B..

Eshte konstatuar fakti qe, pikerisht prova e kerkuara nga pala kerkuese, nuk ka vendim sekuestrimi dhe pa asnje shkak ligjor, pa asnje vendim-marrje qofte te prokurorit, qofte te gjykates nuk ka asnje vendim as per konfiskim te ketyre provave, as per ndonje ruajtje te vecante te tyre, as per asgjesimin e tyre, por as per kthimin e tyre tek pronari i ligjshem.

Nuk rezulton te kete asnje rast te parashikuar nga nenet 217 – 218 te K.Pr.Penale, sipas te cilave te mos lejohet kthimi i ketyre sende te sekuestruara. Gjykata nuk ka asnje arsye te dyshoje per perkatesine e ketyre sendeve; nuk ka vendime gjyqesore per konfiskimin, apo asgjesimin e tyre.

Ne keto kushte, edhe prokurori I pranishem ne seance gjyqesore, eshte shprehur qe ne lidhje me kerkesen e kerkuesit ta cmoje vete ajo .

Nga sa siper, si dhe duke u bazuar ne nenin 217 – 218 te Kodit te Procedures Penale, Gjykata cmon se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi , eshte e mbeshtetur ne ligj e ne prova dhe si e tille ajo duhet te pranohet nga kjo gjykate.

PER KETO ARSYE:

Gjykata, bazuar ne nenin 217 – 218 te K.Pr.Penale,

V E N D O S I:

- Pranimin e kerkeses te kerkuesit L. B.
- .Heqjen e sekuestros te vendosur ndaj mjetit tip BM-X5 me targa AA5.. AB nee pronesi te personit nen hetim L. B.dhe kthimin e tij pronarit te mjetit.
- Shpenzimet gjyqesore sic jane bere .
- Kunder vendimit lejohet ankim ne gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve nga e neserja e shpalljesse ketij vendimi.
- U shpall sot me dt.31.05.2017 ne Tirane

SEKRETARE
MERITA LILA

GJYQTARI
ARBEN KOSTANDINI